

Pa relacion



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E FINANCË, BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 14382 Prot.

Fier me. 17. 12. 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 116, datë 17. 12. 2025

“Për një ndryshim në përdorimin e fondit të kushtëzuar për Mbrojtjen Civile”, për vitin 2025, Bashkia Fier

Në zbatim të Ligjit nr.115/2024 “ Per buxhetin e vitit 2025”, shkresës nr.492/1 prot., datë 25.02.2025, të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, si dhe bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.45/2019 “Per Mbrojtjen Civile”, VKM Nr.414, date 08.07.2021 “ Per Miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, VKM nr.290, date 17.05.2023 “Per një ndryshim në Vendimin nr.414, date 08.07.2021, të Keshillit të Ministrave “Per Miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile, Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar ; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe Udhëzimit nr. 9 , datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave, “Për procedurat standarde të hartimit të buxhetit”, udhëzimeve plotësuese për buxhetin e vitit 2025, Ligjit nr.36/2024 “Per Prefektin” i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë Fier,

PROPOZONË:

1. Të bëhet rishpërndarja e fondeve të kushtëzuara në vlerë **20,381,488.99 lekë**, si më poshtë:

ISHTE

Funksional për dy kode produkti ;

-91707AG- “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës njerëzore” në vlerën 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë,

- 91707AB- “Shtetas të ndihmuar për banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme” në vlerën 5,381,488,99 (pesë milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë presje nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

BEHET

Funksional për një kod produkti ;

- 91707AB- "Shtetas të ndihmuar për banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme" në vlerën **20,381,488.99** (njetete milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e katerqind e tetëdhjetë e tetë presje nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Fier.

Për Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit

Drejtori Pranvera Cina

Per Drejtorine e Emergjencave Civile

Drejtori Nasip Bani

Për Drejtorinë Juridike

Drejtori Esmeralda Kapllanaj

KRYETARI

Armando Subashi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER
DREJTORIA E FINANCË, BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 14382 Prot.

Fier me. 17.12.2025

INFORMACION

“Për një ndryshim në përdorimin e fondit të kushtëzuar për Mbrojtjen Civile”, për vitin 2025, Bashkia Fier

Të nderuar Këshilltarë,

Ky informacion paraqitet përpara të Këshillit të Bashkisë Fier, në zbatim të:

Ligjit nr.115/2024 “ Për buxhetin e vitit 2025”, shkresës nr.492/1 prot.,datë 25.02.2025, të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, ku për Bashkinë Fier është akorduar fondi prej **20,381,488.99 lekë në formën e transfertës së kushtëzuar. Ky fond nuk trashegohet në vitin pasardhës.**

Me shkresë nr.2573/1 prot., datë 28.02.2025, Bashkia Fier i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe ka kërkuar shpërndarjen e fondit të kushtëzuar si më poshtë:

-Kodit të produktit: 91707AG- *“Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme,nëpërmjetë blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës njerëzore”* në vlerën **15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë,**

-Kodit të produktit 91707AB- *“Shtetas të ndihmuar për banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”* në vlerën **5,381,488,99 (pesë milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e katerqind e tetëdhjetë e tetë presje nëntëdhjetë e nëntë) lekë.**

Përgjatë vitit 2025 , Bashkisë Fier i janë shtuar fondet e kushtëzuara për investime në vlerën 5,600,000 lekë për projektin e aplikuar nga Bashkia Fier -18AZ905 “Blerje Autoboti” .

Duke qënë se fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Autoboti” është përlogaritur në vlerën 20,575,260 lekë, dhe nga fondi i investimeve për projektin e mësipërm , për vitin 2025 ,është alokuar 5,600,000 lekë, pjesa tjetër u planifikua nga fondet e kushtëzuara me kod produktit: 91707AG- *“Shpenzime për marrjen e masave parandaluese,lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjetë blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës njerëzore”*, në vlerë 14,975,260 lekë.

Pas përfundimit të procedurave të prokurimit, është lidhur kontrata me nr.5529/20 prot.,datë 28.08.2025, midis AK Bashkia Fier dhe Operatorit Ekonomik START CO Shpk, me objekt

“Blerje Autoboti”, në vlerën 15,452,400 lekë, dhe është depozituar pranë Degës së Thesarit Fier, sipas fondeve të detajuara;

-5,600,000 lekë me kod projekti 18AZ905

-9,852,400 lekë me kod projekti 91707AG

Afati I dorëzimit të mallit është 180 ditë nga nënshkrimi i kontratës , pra deri në fund të muajt shkurt 2026.

Mbështetur në komunikimet e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit me operatorin ekonomik fitues , i cili shprehet se mjeti është ende në proces transporti nga jashtë vendi dhe nuk arrin të vijë deri me datë 31.12.2025.

Duke qënë se fondet e akorduara për Emrgjencat Civile me Buxhet Shteti ,janë në formën e transfertës së kushtëzuar, këto fonde nuk trashëgohen në vitin pasardhës dhe bëhen të papërdorshme me datë 31.12.2025.

Përsa më sipër ,si dhe në mënyrë që këto fonde të mos digjen dhe të bëhen të papërdorshme ,me urdher titullari nr. 14383 prot., Date 17.12.2025 eshte bere nje ndryshim ne perdorimin e fondeve të kushtezuara , si më poshtë:

Ishte Planifikuar

Funksional për dy kode produkti ;

-91707AG- “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese,lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme,nëpërmjetë blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës njerëzore” në vlerën 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë,

- 91707AB- “Shtetas të ndihmuar për banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme” në vlerën 5,381,488,99 (pesë milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e katerqind e tetëdhjetë e tetë presje nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

Për vitin 2025, nga Bashkia Fier është bërë pagesa në vlerë 10,529,088 lekë , për dhënie ndihme financiare për shtetas të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore, përmbytjet 2017-2018, Ferras, Levan, Nj.Admin.Dërmenas.

Pjesa e papërdorur nga fondi total prej 20,381,488.99 lekë do të përdoret për vazhdimin e dhënies së ndihmës financiare, brenda vitit 2025, për shtetas të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore, nga përmbytjet e vitit 2017-2018,në Ferras, Levan dhe Nj.Admin.Dërmenas, të miratuar me VKB nr.36 datë 16.04.2018 ”Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Fier ,së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga përmbytjet që shkaktoi dalja nga shtrati i lumit Vjose në Dhjetor të vitit 2017 dhe Shkurt 2018”, dhe dëmshpërblimin nga përmbytjet e lumit Vjosë ,në Njësinë Administrative Levan , miratuar me VKB nr.10 datë 31.01.2022.

Fondi që mbetet për tu përdorur dhe që do të vijë në ndihmë të shtetasve , banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi natyrore , përmbytje nga Lumi Vjosë, është në vlerën 9,852,400 leke, dhe do te mbulohet nga fondet me kod produkti 91707AG.

Ju faleminderit!

Për Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit

Drejtori Pranvera Cina



Per Drejtorine e Emergjencave Civile

Drejtori Nasip Bani



KRYETARI

Armando Subashi

